



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipality of Istog

01 Numër: 149/018
Data: 19.04.2018

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 43821

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 5 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), lidh:

MARRËVESHJE
ME ORGANIZATËN E VETERANVE TË LUFTËS PËR INVENTARIZIMI E
ZYRËS NË ISTOG

I. PALËT

E lidhur në Istog, më: 19.04.2018, në mes të:

1. Komunës së Istogut, të cilën e përfaqëson, z.Haki Rugova, Kryetari i Komunës, në njërën anë dhe
2. Organizatës të Veteranëve të Luftës të cilën e përfaqëson, z. Bekë Berisha, nga ana tjetër.

II. OBJEKT I MARRËVESHJES

Pika 1

Objekti i kësaj marrëveshje është inventarizimi i Zyrës së OVL-së nga ana e komunës për funksionalizimin dhe krijimin e kushteve për punë në vlerë prej 3,700.00€ (tremijë e shtatëqind euro).

Organizata e Veteranëve të Luftës në Istog kanë rinovuar objektin në vlerë prej 25,000.00€ (njëzet e pesë mijë euro) për realizimin në tersi të këtij projekti komuna ndihmon për inventarizimin e zyrave, andaj komuna ndihmon Organizatën e Veteranëve të Luftës për realizimin e këtij projekti dhe ndanë shumën e mjeteve financiare në vlerë prej 3,700.00€ (tremijë e shtatëqind euro) nga kodi i projektit Nr.43714-Projekti në participim me komunitetin, të programit buxhetor të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.17517 fondi burimor Nr. 22.

III. OBLIGIMET E KOMUNËS

Pika 2

Komuna përmes kësaj marrëveshje obligohet:

Që nga buxheti komunal, përkatësisht nga projekti Nr.43714-Projekti në participim me komunitetin, të programit buxhetor të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.17517 fondi burimor Nr.22, komuna ndanë mjetet financiare në shumë prej 3, 700.00€ (tremijë e shtatëqind euro) për inventarizimin e zyrëve të OVL-së në Istog;

- Të caktojë mbikëqyrësin për përcjelljen e realizimit të projektit;
- Pas njoftimit mbi përfundimin e furnizimit me inventarë për zyre të caktoj komisionin për pranim dhe një anëtar i komisionit të jetë nga Organizata e Veteranëve të Luftës;
- Të njoftoj komunën me dëshmi-fatura për furnizim me inventar ; dhe
- Të ofrojë ndihmë përkatëse në realizim të projektit të lartcekur.

IV. OBLIGIMET E ORGANIZATËS SË VETERANËVE TË LUFTËS

Pika 3

Organizata përmes kësaj marrëveshje obligohet:

- Të caktoj një përfaqësues të OVL-së për bashkëpunim me komunën;
- Pas përfundimit me furnizime të inventarit të caktojnë një anëtar në komisionin për pranimin e inventarit;
- Të eliminojë pengesat e çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të projektit në fjalë;
- Të caktoj përfaqësuesin e OVL-së i cili do të bashkëpunoj me komunën për realizimin e këtij projekti.

V. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Pika 4

Palët e kësaj marrëveshje do të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë marrëveshje t'i zbatojnë më përpikëri.

Palët në marrëveshje për çdo paqartësi apo vërejte, në zbatim të obligimeve të kësaj marrëveshje komunikojnë në mes veti në formë të shkruar.

VI. NDRYSHIMI I MARRËVESHJES

Pika 5

Kjo marrëveshje apo një pjesë e kësaj marrëveshje mund të ndryshohet apo modifikohet nëse palët për këtë ndryshim apo modifikim pajtohen. Ndryshimi bëhet në formë të shkruar dhe është aneks i kësaj marrëveshje.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

Pika 6

Kjo marrëveshje hyn në fuqi më nënshkrimin e saj nga palët në marrëveshje.

Pika 7

Në rast të çdo mosmarrëveshje palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast të dështimit të zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve eventuale përmes bisedimeve, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata Themelore Pejë - Dega në Istog.

Marrëveshja është hartuar në 4 kopje identike njëra me tjetrën, një kopje për Organizatën e Veteranëve të Luftës në Istog, një kopje për Drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe dy kopje mbesin në arkivin e komunës.

PALET NË MARRËVESHJE

per
PËR KOMUNËN E ISTOGUT
Kryetari i Komunës
z. Haki RUGOVA

[Signature]

KRYETARI
OVL-ISTOG

z. Bekë Berisha

[Signature]



nënshkruar më: 20/04/2018



nënshkruar më: 20/04/2018